



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr. 48, dt. 23.12.2024

**MBI MIRATIMIN E KALENDARIT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026
PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 7 dt. 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit nr. 23, datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

V E N D O S I

1. Të miratojë Kalendarin për procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të përgatitur sipas Sistemit të menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Buxhetit vjetor 2026 për Këshillin e Qarkut.
2. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Ekipi për Menaxhimin e Programeve dhe Administrata e Këshillit të Qarkut për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga 01 Janari 2025.

KRYETARI

Erjon Nexhipi



Miratuar me / 19 / Vota
Vota Pro / 19 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /23/12/2024
Konceptoi O.Beqiraj
Juristi M.Bylykbashi
Sek.Kesh.Qarkut B. Muço

Aneksi 2

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026

Fazat	Nr	VEPRIMI PERKATES	Struktura Përgjegjëse	Afati
FAZA I	Hapi I	Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe I buxhetit vjetor	Kryetari dhe struktura përgjegjëse për buxhetin	Deri në 31 dhjetor 2024
	Hapi II	Përgatitja e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028	GMS	Deri me 31 Janar 2025
		Paraqitet për shqyrtim e miratim në këshill raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028	Kryetari	Deri me 1 Mars 2025
		Miratimi i raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave.	Këshilli i Çarkut	Deri me 1 Mars 2025
	Hapi III	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Misionit . 2. Shqyrtimi dhe miratimi i strukturës së programeve. 3. Miratimi i kalendarit të brendshëm për realizimin e procedurave të PBA -së.	Mbledhja e I GMS	Deri me 5 Mars 2025
		Përgatitja e taveve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm.	Mbledhja e II GMS	Deri me 10 Mars 2025
		Këshilli i njësishë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Këshilli i Qarkut	Deri me 15 Mars 2025
	Hapi IV	GMS harton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit dhe kryetari e miraton dhe e shpërndan tek sektorët me: a) përcaktimin e programeve buxhetore dhe të ekipit të menaxhimit të programeve përkatëse; b) tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	GMS/Kryetari	15-20 Mars 2025
		a. Përgatitja e nje kalendarit të detajuar për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore në përputhje me kalendarin bazë të miratuar nga KQ. b. Rishikon strukturën e programeve të NJQV dhe nëq është e nevojshme bën propozime për ndryshime. c. Dërgon kopje të udhëzimit vjetor të PBA dhe kalendarin të të gjithë anëtarët e GMS	Nëpunësi zbatues në rolin e Sekretarit të GMS përgatit për Kryetarin dhe GMS	
	Hapi V	Pas shpërndarjes së taveve përgatitore sipas programeve fillon përgatitja e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm sipas udhëzimit të miratuar nga Kryetari. Përgatitja e planeve të shpenzimeve , formulareve të propozimit të projekteve të investimeve dhe kërkesave për shpenzime shtesë për çdo program dhe dorëzimi tek Kordinatori i GMS. Hartimi i kërkesave buxhetore dhe të gjithë formave përkatëse. Hartimi i relacioneve shpegues për çdo program.	GMS/EMP	Deri 20 Maj 2025
		Dërgohet në Ministrinë e Financave dokumenti i parë i programit buxhetor afatmesëm në formë elektronike dhe shkresore.	Kryetari	Deri 1 Qershor 2025
	Hapi VI	Ministria e Financave analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm dhe e sjell zyrtarisht në institucion.	Ministria e Financave	Deri 20 Qershor 2025
		Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm, duke u bazuar edhe mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	Këshilli i Qarkut	Deri 30 Qershor 2025
		Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të miratuar.	Kryetari	1-5 Korrik 2025

FAZA II	Hapi I	Përgatitja e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi dhe hartimi i projekt vendimit për miratimin nga Këshilli i Qarkut me relacionin përkatës.	Kryetari	10 - 15 Korrik 2025
		Këshilli miraton tavanet përfundimtare		Deri në 20 Korrik 2025
		Kryetari i NJQV harton udhëzime për përgatitjen e buxhetit dhe e shpërndan tek sektorët me: a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; b) afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Kryetari	20-25 Korrik 2025
	Hapi II	Rishikimi i dokumentit të parë të Programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe përgatitja e materialit për miratim në Këshill.	EMP/GMS/Kryetari	1-10 shtator 2025
		Miratimi i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të rishikuar	Këshilli i Qarkut	Deri 15 Shtator 2025
		Dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 të rishikuar dhe të miratuar nga këshilli i qarkut, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MFE gjatë fazës së parë.	Kryetari	Deri 15 Shtator 2025
		Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Deri 20 Tetor 2025
		Hartimi i projektbuxhetit vjetor me tabelat përkatëse dhe relacionet për miratim në Këshill.	Sektoret/GMS/Sektori i Financës	Deri në 30 Nëntor 2025
		Pas marrjes së mendimeve përfundimtare dhe bashkërendimit me Projekt buxhetor vjetor, paraqitet për miratim në këshill Dokumenti përfundimtar i PBA 2026-2028	Kryetari	Deri në 30 Nëntor 2025
		Propozojnë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari.	Këshilli i Qarkut	Deri 10 Dhjetor 2025
	Hapi III	Dokumenti përfundimtar i programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti i vitit 2026 kalojnë për miratim në Këshillin e Qarkut.	Këshilli i Qarkut	Deri 25 Dhjetor 2025
		Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqëruar	Kryetari	Deri 31 Dhjetor 2025
		Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave	Kryetari	Ju më vonë se 5 ditë nga Konfirmimi i tij
		Publikimi i buxhetit vjetor me informacionin përkatës	Kryetari	Ju më vonë se 15 ditë nga miratimi në Këshill

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Erjon NEXHIPI

